



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:069265
Datë: 22.04.2022
Numri i dokumentit: 02947945

C.nr.423/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, Gjyqtarja Mirjeta Shala, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit A.B., nga Gj., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson i autorizuari Arbër Guta, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të udhëtimit, vlera e kontestit 448,80€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesorë publik, në prani të autorizuarit të paditësit e në mungesë të palës së paditur, me datën 12 prill 2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.B. nga Gj., ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, që paditësit A.B., nga Gj., të ia paguaj:

- në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, për periudhën kohore 18.04.2017 e deri me datën 28.02.2021, respektivisht për 132 ditë të pranisë në punë shumën prej 264,00€, dhe
- në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit për ditët e pranisë në punë, për periudhën si dhe kohore nga data 18.04.2017 deri me datën 28.02.2021, respektivisht për 132 ditë të pranisë në punë shumën prej 184.80€,

në shumën e përgjithshme prej 448,80€, e këtë me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 12.04.2021(data e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive, këtë në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditësit A. B. nga Gjakova, të ia kompensojë shpenzimet procedurale në shumën e përgjithshme prej 259.20€, në afatin prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësi në padinë e parashtruar në këtë gjykatë me datë 12.04.2021 përmes të autorizuarit të lartpërmendur të tij, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit në punë. I autorizuari i paditësit, në padi, në fjalën e dhënë në shqyrtimin kryesorë dhe në fjalën e tij përfundimtarë ka parashtruar se i njëjti është i punësuar tek e paditura, përkatësisht në SHFMU “D..” në fshatin H., Komuna Gjakovë, mësimdhënës i mësimit klasor-lënda Gjuhë Gjermane, dhe se është anëtar i SBASHK, duke paguar anëtarësi mujore prej 0.5%. Kërkesat e paditësit për një kompensim të këtillë gjejnë mbështetje në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës, e sidomos në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, datë 18.04.2017, neni 35 par. 5, dhe 7, ku është specifikuar kompensimi për shpenzimet e udhëtimit dhe ushqimit. Bazuar në të dhënat zyrtare të lëshuara nga institucioni i lartpërmendur, këtu paditësi nga data kur ka hyrë në fuqi Kontrata Kolektive, prej datës 18.04.2017, respektivisht nga data 01.01.2020 (viti akademik 2019/2020), kur edhe ka themelur marrëdhënie të punës, e deri me datë 28.02.2021, ka punuar 132 ditë pune, për çka edhe kërkon kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në lartësi prej 264,00 euro si dhe duke marrë për bazë se paditësi udhëton në itinerarin Gjakovë – Hereç dhe anasjelltas, ku paguan biletë kthyesë në lartësi 2,00 euro, kur shumëzohet 70 % i këtyre biletave ($70\% * 2 = 1.40$) me 132 ditë e pranisë në punë, i bie se e paditura i ka mbetur borxh shumë prej 184.80 euro, në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit. Paditësi ka qenë i detyruar që kërkesën e tij ta realizoi përmes Gjykatës, pasi që e paditura nuk i është përgjigjur kërkesës së tij, andaj Gjykatës në rastin konkret i ka propozuar që kërkesë padinë të e aprovojë si të bazuar, ashtu që të detyrohet e paditura, që paditësit në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit në unë, t i paguaj shumë e përgjithshme prej 448, 80€ me kamatën ligjore prej 8% duke filluar nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjyqimit e nën kërcënim të pambarimit me dhunë.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar sipas Tarifës për Avokat dhe atë: për përpilimin e padisë shumë prej 104,00 euro, për përfaqësimin në një seanca gjyqësore shumë nga 135,00 euro, si dhe për pagesën e taksës gjyqësore shumë prej 20,00 euro, përkatësisht shumë e përgjithshme prej 259.20 euro.

Gjykata ia ka proceduar këtu të paditurës aktvendimin e datës 12.05.2021 (për dhënien e përgjigjes së detyrueshme në padi), padinë dhe provat materiale, të cilat e njëjta i ka pranuar me datë 17.05.2021 (siç vërtetohet nga fletëkthesa e cila gjendet në shkresat e lëndës), mirëpo deri në momentin e përpilimit të këtij aktgjykimi, nuk ka parashtruar fare përgjigjen në padi, përkundër obligimit ligjor.

Gjykata me propozimin e të autorizuarit të paditëses dhe në kuptim të nenit 423.4 të LPK-së, shqyrtimin kryesor e mbajti në mungesë të paditurës së ftuar në mënyrë të rregullt.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: Kontrata e punës e lëshuar nga Komuna e Gjakovës, Drejtoria Komunale e Arsimit, në versionin e fotokopjuar, e vërtetuar, me nr. Leg.nr. 942/21, dt.

09.03.2021, Vërtetimi i lëshuar nga SBASHK-u , Vërtetimi i lëshuar nga “SHFMU “D..” në F.sh. H. K. Gjakovë, me Nr. të Prot. 147/2021, i dt. 01.03.2021, Certifikata e vendbanimit me Nr. Ser. B10310830 e lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Fsh. C. K. Gjakovë, Monitorimi i transaksioneve të llogarisë e lëshuar nga TEB Bankë, Kërkesa për realizimin e kompensimeve nga Kontrata kolektive e dorëzuar te e paditura me dt. 18.03.2021, me nr. 0461/21-6306, Vërtetimi i lëshuar nga Shoqata e transportit në Gjakovë.

Gjykata pas analizimit të fakteve juridike relevante të kësaj çështjeje, vlerësimi veç e veç të provave dhe lidhshmërinë e tyre reciproke, e në kuptim të nenit 8 të LPK-së, vërtetojë se kërkesëpadia e paditësit, është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga provat e administruara, u vërtetua gjendja faktike si në vijim:

Nga Kontratë punës e lëshuar nga Komuna e Gjakovë – Drejtoria e Arsimit, në versionin fotokopje, e vërtetuar me numër Leg.nr.942/21 e datës 09.03.2021 është vërtetuar fakti se paditësi është në marrëdhënie pune në Institucionin Arsimor : shkolla “D..”, vendi i punës: mësimdhënës i lëndë Gjuhë Gjermane.

Nga Vërtetimi i lëshuar nga SBASHK-u i datës 01.03.2021, vërtetohet fakti se paditësi është anëtar i SBASHK.

Nga Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “D..” në fshatin H., me Nr. të Prot. 147/21, i datës 01.03.2021, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune që nga viti 2019 dhe ende vazhdon të punojë, dhe nga data 18.04.2017, përkatësisht nga data 01.01.2020(viti akademik 2019/2020) e deri me datë 28.02.2021 ka vijuar 132 dite pune.

Nga Kërkesë për realizimin e kompensimeve nga Kontrata Kolektive e pranuar nga Komuna Gjakovës, me nr. 04-610/21-6306 i dt. 18.03.2021, është vërtetuar rrethana se këtu paditësi i është drejtuar Organit të lartcekur, për të përmbushur kërkesat e tij në raport me shpërblimin, shpenzimet e ushqimit dhe shpenzimet e udhëtimit, bazuar në Kontratat Kolektive.

Nga Certifikatë e vendbanimit me nr. Ser.B10310830e lëshuar nga Zyra e gjendjes Civile në C. e datës 09.03.2021, është vërtetuar fakti se këtu paditësi jeton në Gj., Rr, ”Nëna Tereza” p.nr.

Nga Vërtetimi i lëshuar nga Shoqata e Transportit në Gjakovë, është vërtetuar fakti se çmimi i biletës në relacionin Gjakovë – Hereç, në një drejtim kushton 1,00 euro.

Gjykata në raport me kërkesën e parë të paditëses e cila i referohet shpenzimeve të ushqimit, duke u bazuar në provat e lartcekura si dhe në dispozitën ligjore të nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë datë 18.04.2017 dhe Kontratën e datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se: *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo*

kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim, për t'a bërë kompensimin", erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit për këtë kompensim është e themeltë, për çka të njëjtit i takon kompensimi i kërkuar për këtë kriter, ngase nga Kontratë e punës, është provuar fakti se paditësi ka lidhur kontratë me të paditurën – shkollën "D.." H., ndërsa vërtetimi i lëshuar nga shkolla e lartpërmendur vërteton faktin se paditësi nga data 18.04.2017 e deri me datë 28.02.2021 ka vijuar 132 dite të pranisë në pune, andaj gjykata marrë parasysh kërkesën e paditësit për këtë periudhë, ia njohu këtë kërkesë në shumë prej 264,00 euro, duke bërë përlllogaritjen si në vijim: $132 \times 2.00 \text{ euro} = 264,00 \text{ euro}$.

Sa i përket kërkesës tjetër të paditësve e cila i referohet shpenzimeve të udhëtimit, gjykata duke u bazuar në provat në të gjitha provat e lartcekura si dhe në nenin 35.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 me numër 01/B 2056, ku është paraparë se: *"Mësimdhënësit që udhëtojnë në vendbanimet e Komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban"*, si dhe nenit 35 par. 5 si dhe të Kontratës së datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit për punonjësit arsimor, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit edhe për këtë kompensimin (të shpenzimeve të udhëtimit) është e themeltë. Kjo pasi që, nga gjendja faktike e vërtetuar, rezultojë se paditësi është e punësuar te e paditura përkatësisht në SHFMU "D.." në fshatin H., dhe i njëjti për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 28.02.2021 ka realizuar 132 ditë të pranisë në punë në këtë institucion shkollor. Për këto ditë të realizuara në punë paditësi çdo ditë punë, ka udhëtuar nga vendbanimi i tij Gjakovë për në vend punimin e tij në SHFMU "D.." në fshatin H. Lartësinë e çmimit të biletës gjykata e vërtetoi në bazë të vërtetimit të lëshuar nga Shoqata e Transportit në Gjakovë, ku për relacionin nga vendbanimi, për në vend punimin e tij, paditësi ka paguar 2.00€ në ditë për të dy drejtimet. Andaj për 132 ditë pune $\times 2\text{€} \times 70\% = 1.40\text{€} = 184.80\text{€}$, e paditura është e detyruar që të i'a kompensojë këtë lartësi për këtë kriter të kompensimit.

Sipas nenit 8 par. 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në "Gazetën Zyrtare" të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, është paraparë se: *"Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij"*. Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: *"Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij"*, prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditorit, përkatësisht këtu paditëses, të ia paguajë vlerën e aprovuar të kërkesëpadisë si dhe shpenzimet tjera aksesore, siç më detajisht është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatëvonesën gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku parashihet se *"Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën"*, tutje paragrafi 2 i këtij neni parasheh se *"Lartësia e kamatëvonesës është 8% në vit, për veç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë"*, andaj meqenëse e paditura ka rënë në vonesë në kompensimin e obligimit sa i përket kompensimit lidhur me shpenzimet e ushqimit dhe shpenzimeve të udhëtimit që ka pasur ndaj

këtu paditësit, gjykata vlerëson së përpos kërkesës kryesore, të njëjtës i takon edhe kamata e gjykuar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muar sipas nenit 452 par. 1 të LPK-së, me ç' rast paditësit iu pranua shume e përgjithshme e shpenzimeve në vlerë prej 259.20€.Lartësia e shpenzimeve i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20,00€(e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 104,00€, si dhe përfaqësimin e të autorizuarit të paditëses në një seancë, shuma në vlerë prej 135,20€(të parapara sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës).

Prandaj, gjykata, bazuar ne arsyet e cekura me larte, bazuar ne nenin 143 të LPK-së, vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.423/2021, me 12 prill 2022.

Gj y q t a r e,
Mirjeta Shala

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.

Numri i lëndës: 2021:069265
Datë: 22.04.2022
Numri i dokumentit: 02947945